



UNMIK

IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETË QEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

Kabineti i Ministrimit

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

Office of the Minister

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Këshilli i Ekspertëve për Planprograme dhe Tekste Shkollore

NUMËR: MASHT[I] 15/2005

DATË: 25.04. 2005

Në bazë të nenit 1.3 pika ç) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes në Kosovë, nenit 1 pika x) dhe nenit 12.6 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë (më poshtë MASHT) nxjerr këtë Udhëzim Administrativ:

Neni 1

Qëllimi

- 1.1.** MASHT-i themelon Këshillin e Ekspertëve për Plane e Programe dhe Tekste Shkollore (më tutje Këshilli).
- 1.2.** Këshilli themelohet me aktin e nënshkrimit të këtij Udhëzimi Administrativ sipas procedurës së paraparë .
- 1.3.** Anëtarët e Këshillit i zgjedh MASHT-i sipas kriterëve profesionale.
- 1.4.** MASHT-i emëron anëtarë të rinj të Këshillit mbi bazën e kriterëve paraprake për ta plotësuar përbërjen e Këshillit, nëse kjo është e nevojshme.

Neni 2

Përbërja e Këshillit

- 2.1** Këshilli ka deri në 19 anëtarë. Ata janë ekspertë të njohur nga fushat e ndryshme lëndore, ekspertë nga shkollat dhe institucionet e tjera, ekspertë të teknologjisë dhe

nga ekonomia e tregut, nga këshillat e prindërve dhe nga radhët e ekspertëve ndërkombëtarë.

- 2.2. Anëtarë konsultativë të Këshillit do të jenë së paku një deri në tre ekspertë ndërkombëtarë.
- 2.3. Anëtarët e Këshillit zgjidhen me mandat katërvjeçar. Ata zgjedhin kryetarin e Këshillit nga radhët e anëtarëve të vet.
- 2.4. Secili anëtar i Këshillit konfirmon anëtarësinë në Këshill me kontratë të bërë me MASHT-in.
- 2.5. Palët kontraktuese mund ta shkëpusin kontratën me palën tjetër pas një paralajmërimi paraprak prej 30 ditësh. Plotësimi i anëtarëve të Këshillit bëhet në përshtatshmëri me nenin 2, pika 2.4 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 3

Struktura organizative

- 3.1. Këshilli formon komisionet, të përbëra nga tre ose katër anëtarë.
 - Shtatë komisione sipas lëmenjve mësimorë (gjuhë dhe komunikim, matematikë, shkencat natyrore, shkencat shoqërore, artet, edukatë fizike dhe teknologji)
 - Dhjetë komisione sipas lëmenjve mësimorë nga arsimit profesional
 - Tri komisione për arsimin e të rriturve
 - Dy komisione për arsimin special
 - Tri komisione për arsimin ndërlëndor, ndërprogramor, çështjen gjinore dhe mësimin zgjedhor
- 3.2. Anëtarët e komisioneve i zgjidh Këshilli sipas propozimit të anëtarëve të Këshillit.
- 3.3. Anëtarët e komisioneve zgjidhen me mandat katërvjeçar. Ata zgjedhin kryetarin e Komisionit nga radhët e anëtarëve të vet.
- 3.4. Komisionet kryejnë detyrat e përcaktuara nga Këshilli konform nenit 7 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 4

Përgjegjësitë e Këshillit

- 4.1. Anëtarët e Këshillit nuk mund të vlerësojnë apo ta bëjnë redaktimin e teksteve, autorë të së cilave janë vetë.
- 4.2. Këshilli ka dy funksione primare: vlerësimin dhe rivlerësimin e planeve e të programeve dhe të teksteve shkollore, në mënyrë që të japë mendimin e vet se plane e programe mësimore dhe tekste shkollore i plotësojnë standardet për zbatimin e Programit Arsimor të Kosovës.
- 4.3. Këshilli themelohet për mbikëqyrjen dhe për redaktimin profesional të Planit dhe të Programit të ri për lëndët mësimore nga klasa e parë e arsimit fillor deri në klasën e trembëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë.

4.4. Këshilli përkujdeset që për çdo vit shkollor në edukimin parashkollor, në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të ketë tekste të përshtatshme për secilën lëndë sipas Programit Arsimor të Kosovës.

Neni 5

Qëllimet

- 5.1. Shkolla dhe mësuesi të kenë më tepër autonomi dhe përgjegjësi në procesin mësimor.
- 5.2. Të pengohet stërngarkimi dhe lodhja e nxënësve nga informatat e tepërta dhe të parëndësishme.
- 5.3. Të rritet shkalla e përfshirjes së fëmijëve, rinisë dhe të rriturve në arsimim, rritja e shkallës së kalueshmërisë me rritjen e kualitetit.
- 5.4. Përgatitja e nxënësve për jetë kualitative, arsimim të përgjithshëm dhe për profesion.
- 5.5. Të arrihet një shkallë më e lartë e lidhjes ndërlëndore dhe ndërprogramore.

Neni 6

Detyrat

- 6.1. Këshilli, rishikon, analizon dhe propozon për miratim Kornizën e Planit dhe të Programit të Përgjithshëm të Kosovës.
- 6.2. Përcakton dhe aprovon strategjinë afatgjatë dhe planin kohor të veprimit për zhvillimin e planeve dhe të programeve lëndore.
- 6.3. Përcakton kriteret për zgjedhjen e ekspertëve për zhvillimin e planeve dhe të programeve dhe formimin e komisioneve.
- 6.4. Këshilli rishikon, shqyrton dhe vlerëson çdo plan e program lëndor, duke respektuar këto kriteret:
 - (a) Përputhshmërinë me Programin Arsimor të Kosovës;
 - (b) Përshtatshmërinë e planit e të programit për secilën klasë, duke filluar nga edukimi parashkollor, shkolla fillore, shkolla e mesme e ulët dhe shkolla e mesme e lartë;
 - (c) Harmonizimin e përmbajtjes me objektivat apo rezultatet e të nxënit;
 - (d) Përshtatshmërinë e përmbajtjes dhe të objektivave të planit e të programit, aftësive mendore dhe emocionale të nxënësve të asaj moshe të atij niveli;
 - (e) Dedikimin e planit dhe të programit nxënësve me nevoja të veçanta (p.sh. me aftësi për të kuptuar me vonesë apo atyre që kanë aftësi më të mëdha se të tjerët);
 - (f) Përshtatshmërinë e planit dhe të programit me politikën qeveritare lidhur me respektimin dhe të kuptuarit e diversitetit kulturor në Kosovë;

- (g) Promovimin e tolerancës dhe të mirëkuptimit në plan dhe program dhe në mënyrën e mësimdhënies;
- (h) Artikulimi i standardeve të arritshmërisë në raport me standardet e përmbajtjes, njohuritë dhe me shkathtësitë e nxënësve?
- (i) Lidhja ndërlëndore me planet dhe programet e tjera, ku rezultatet e pritura do të jenë të ngjashme;
- (j) Përfshirja e temave nga jeta (p.sh. çështja gjinore, edukimi shëndetësor, arsimi për ndërmarrës, të drejtat dhe liritë e njeriut etj.) si çështje ndërprogramore në kuadër të planeve dhe të programeve lëndore;
- (k) Orientimet e qarta për vlerësimin, qasjet metodologjike, mësimdhënien dhe mësimnxënien.

6.5. Në kompletimin e kësaj analize dhe të këtij procesi vlerësues, Këshilli, aty ku është e nevojshme, bën rekomandime për MASHT-in se si duhet të ndryshohen ose të përmirësohen planet dhe programet lëndore, që të plotësohen kërkesat e Programit të Arsimit në Kosovë.

6.6. Këshilli vlerëson çdo tekst shkollor pas vlerësimit paraprak të një komisioni të ekspertëve, në mënyrë që teksti t'i plotësojë standardet e pranueshme programore.

6.7. Këshilli bën vlerësimin e teksteve shkollore, që të propozojë lejimin e tyre për përdorim në shkolla.

6.8. Vlerësimi i teksteve duhet të bazohet në këto kritere:

- a) Përshtatshmëria me programin mësimor lëndor;
- b) Përshtatshmëria me moshën e nxënësve në secilën klasë të nivelit të caktuar;
- c) Sigurimi i informacioneve themelore për përmbajtjen e lëndës dhe të udhëzimeve për zbulimin e informatave alternative;
- d) Sigurimi i materialit të bollshëm ilustrativ, i cili është në funksion të zbërthimit më të lehtë të përmbajtjes programore;
- e) Sigurimi i informacioneve të vlefshme dhe të sakta për t'i identifikuar dhe për t'i zgjidhur problemet e ndryshme në mënyrë krijuese.

Neni 7

Pagesa

7.1. MASHT-i obligohet që t'i paguajë anëtarët e Këshillit për punën që e bëjnë në formë honorari, sipas kontratës së nënshkruar nga të dy palët.

7.2. Nëse anëtari i Këshillit nuk i kryen obligimet konform Udhëzimit Administrativ dhe afateve në planin e veprimit, MASHT –i nuk bën pagesën e honorarit për kohën e caktuar.

Neni 8

Raporti vlerësues

- 8.1** Raportin me sygjerimet, vlerësimet dhe rekomandimet Këshilli e dorëzon në afatin e caktuar me kontratë nga MASHT-i.
- 8.2** Në raport duhet të jenë të skicuara mirë mënyra e vlerësimit dhe propozimet për përmirësimin e programit dhe të tekstit shkollor, nëse është e nevojshme.
- 8.3** Nëse ka nevojë që të bëhen shumë përmirësime, atëherë programi mësimor apo teksti shkollor duhet t'u rikthehen hartuesve për ripunim.

Neni 9

MASHT-i i lejon për përdorim planet, programet mësimore dhe tekstet shkollore sipas propozimit të Këshillit.

Neni 10

Zbatimi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Agim Veliu, Ministër